forum 2015

Seria e analizave "Çka shkoi ters?"

TOP PROBLEMET ZGJEDHORE

Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor

forum 2015

Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur
Projekat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo
Project of the Kosovo Foundation of Open Society

Seria e analizave “Çka shkoi ters?

Top problemet zgjedhore

Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor

Copyright © 2013. Forum 2015.

Ky studim u hartua nga Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi. Ky raport u prodhua për Forum 2015 dhe u financua nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi e vetme e Demokracisë për Zhvillim (D4D).

2013 Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Publikuar nga:
Forum 2015 - projekt operacional i KFOS

Përktheu në gjuhën shqipe:
Qerim Ondozi

Imzot Nikë Prela nr. 13
10 000 Pristina
Kosovo

Për më shumë informata:
info@kfos.org
www.kfos.org

Përmbajtja

Hyrje **5**

Të përgjithshme

Problemi 0 – ‘Deforma’ zgjedhore 7
Problemi 1 – Lista e votuesve 8
Problemi 2 – Vakumi ligjor dhe diskrecioni 10
Problemet 3 – KQZ 11

Dita e Zgjedhjeve

Problemi 4 – Drejtorët e shkollave dhe komisionerët e vendvotimeve 16
Problemi 5 – Turmat 17
Problemi 6 – Kanosja e votuesit 18
Problemi 7 – Fshehtësia e votës 19
Problemi 8 – Fletëvotimi me kusht dhe me postë 20
Problemi 9 – Votimi për tjetrin 21
Problemi 10 – Votimi në grup 23

Numërimi & procesi paszgjedhor

Problemi 11 – Vota preferenciale 24
Problemi 12 – Gjobat e ulëta & Gjykatat jofunksionale 26

Hyrje

Kur bëjmë vizitë të rregullt mjekësore, kemi tendencë të përqendrohemi në vlera të cilat veçohen. Brengosemi për rezutatet brengosëse dhe ngushëllohemi shumë pak me pjesën tjetër të rezultateve normale. Në njëfarë mënyre, duket se nuk mërzitemi për shëndetin e gjithë popullit në nivel të njejtë. Të frymëzuar nga ky krahasim, ky studim i shkurtër politik vë në pah manipulimet zgjedhore më të shpeshta dhe më të përsëritshme në Kosovë.



Raportet e këtilla kritike të cilët ne zakonisht i publikojmë kanë një disavantazh të madh sepse autoritetet i shohin ato si shumë kritike dhe që nuk japin lëvdata të merituara për zhvillimet pozitive. Megjithatë, është vetë natyra e raporteve të 'kontrollimit' që të përmirësohen çështjet publike duke u përqendruar në fusha të cilat kanë më së shumëti nevojë për përmirësim. Qëllimi është vetëm që t'i ndihmohet pacientit ta përmirësojë pikëpamjen e tij.

Ky studim vjen pas disa vitesh pune zgjedhore nga D4D duke përfshirë hulumtime, vëzhgime, përcjellje të trendeve, analiza të trendeve, ose analiza të rezultateve, një numër të madh publikimesh të fokusuara në sistemin zgjedhor, procesin, punën e komisionit parlamentar për reformën zgjedhore, listën e votuesve dhe punën e KQZ-së.

Mashtrimet zgjedhore i njollosën zgjedhjet e vitit 2010 në vend dhe çuan në një ngërç institucional gjashtëmujor, pasojat e të cilit ende i vuan Kosova. Një përsëritje e niveleve të tilla të manipulimit me siguri do të mund të shkaktonte dhunë politike Lidershipi politik u përfshi me gjysmë zemre në një reformë vitin e kaluar. Fatkeqësisht, ata u përqendruan vetëm në zgjidhjet sistematike të cilat u shërbejnë atyre për ta maksimalizuar fitoren politike. Në këtë aspekt, reformat që rezultuan u motivuan shumë pak përtej kalkulimeve të partive politike.

Studimi i Fizibilitetit i BE-së i vitit 2012 doli në përfundim se zgjedhjet në Kosovë u përcollën me mangësi serioze[1]. Bashkësia ndërkombëtare e sheh rëndësinë e parandalimit të mashtrimeve dhe e këshillon Kosovën ta thjeshtësojë sistemin zgjedhor.

1 Komisioni Europian. Studimi i Fizibilitetit i BE-së 2012, faqe 7. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf (qasja e fundit 19 mars 2013).

Ka disa përmirësime të menaxhimit zgjedhor në Kosovë, siç u vërejt nga progresi i zgjedhjeve plotësuese për kryetar të komunës në Ferizaj dhe Kaçanik në 2012, dhe nga një trend më pozitiv i drejtësisë zgjedhore.

Kjo qasje përdor analogji mjekësore. Shumë kosovarë e vizitojnë mjekun shumë vonë, kurrë nuk e dëgjojnë diagnozën e saktë të mjekut dhe recetën nuk e marrin seriozisht. Për fat të keq, nuk ka mjek zgjedhor, dhe kosovarët do të duhet ta bëjnë vetë testin e tyre, të përballen me diagnozën dhe të përfshihen në një trajtim afatgjatë. D4D nuk beson në zgjidhje të lehta e të shpejta, ngase ato nuk ekzistojnë. Sistemi duhet të ndërtojë imunitet dhe të përqendrohet në parandalim. Vakumi për mashtrime mbetet i hapur krah me krah, dhe për këtë arsye D4D dhe Forum 2015 zgjodhën që të përqendrohen në top dhjetëshin e problemeve zgjedhore dhe në teknika për t'i adresuar ato. Mbyllja e hapësirës për mashtrime është punë e mundimshme dhe e detajuar (aty qëndron i gjithë problemi, siç është dëshmuar anembanë).

Ky studim trajton secilën praktikë mashtruese zgjedhore në një apo dy faqe. Secila teknikë për mashtrim apo hapësirë për manipulime fillon me diagnozë të problemit dhe përcillet me një rekomandim. Dhjetë kapitujt janë të organizuar në tri tema të përgjithshme që i përkasin fazave të ndryshme të zgjedhjeve: (a) të përgjithshme, (b) dita e zgjedhjeve, dhe (c) numërimi dhe procesi paszgjedhor.

Problemi 0 – ‘Deforma’ zgjedhore

Ata që mërziteshin se Kosova nuk ka industri u lehtësuan kur dëgjuan se, në fakt, ka. Kur vjen puna te mashtrimet zgjedhore, ishte pikërisht termi ‘industrial’ ai që u përdor për të përshkruar shkallën e manipulimit. Pasoi kriza institucionale gjashtëmujore dhe pak pas zgjidhjes së saj u inicua reforma zgjedhore.

Diagnoza
Për fat të keq, marrëveshja politike dhe rezoluta parlamentare që i hapi rrugë reformës nuk e citoi mashtrimin si forcën shtytëse. Gati dy vjet më vonë, dhe pas dy angazhimeve të kufizuara nga ana e komisionit parlamentar, mobilizmit masiv të bashkësisë ndërkombëtare, reforma ka hyrë në një rrugë qorre.

Reforma ka devijuar në atë shkallë saqë ka filluar të quhet ‘deformë’. Ekziston një draft ligj i papërfunduar që i sjell pak dobi nevojave për zgjedhje të duhura. Sukseset kryesore që shpesh përmenden janë shkurtimi i fushatës parazgjedhore apo zbatimi i dënimeve kolektive. Në radhe të parë po kalojnë reformat me interes të qartë politik.

Në një situatë pa rrugëdalje, procesin e kanë marrë përsipër kryetarët e partive dhe ka mundësi që të kompromethohet edhe më shumë për t’i shërbyer vetëm interesave të tyre. Me siguri se liderët më të fortë do ta bëjnë sipas mënyrës së tyre dhe do t’i nënshtrojnë partitë nën vullnetin e grupeve të tyre të ngushta të interesit. Qasja e tyre ngrit dyshimin se ’reforma’ të cilën e synojnë disa liderë dhe partitë politike është të makimalizohen korrjet e votave dhe që ata të konfirmohen si liderë të padiskutueshëm të cilët do t’i kenë duart e lira për ta udhëhequr partinë e tyre politike dhe shtetin.

Ilaçi
Shoqëria civile ia doli që t’i shtyjë përpara disa reforma të rëndësishme, por duhet të vijnë edhe shumë të tjera. Shoqëria civile po lobon për një sërë rekomandimesh siç është KQZ-ja e balancuar ndërmjet pozitës dhe opozitës, lista të ndara të votuesve nga diaspora, komisionerët të shërbejnë në komunat tjera e jo në ato nga të cilat vijnë dhe një numër rekomandimesh tjera të cilat nuk janë atraktive për partitë politike kryesore. Procesi i reformës zgjedhore duhet t’i kthehet komisionit parlamentar për reformën zgjedhore i cili duhet ta vazhdojë punën të cilën e ka nisur. Rekomandimet e shoqërisë civile si dhe ato të opozitës duhet të merren më seriozisht në mënyrë që reforma të jetë kuptimplotë. Interesat e shoqërisë së Kosovës duhet të kenë më shumë peshë sesa interesat afatshkurtë të liderëve të partive politike.

Problemi 1 – Lista e votuesve

Njëri prej probleme më të mëdha zgjedhore në Kosovë është lista e votuesve. Ekzistojnë me qindra mijëra kosovarë që jetojnë jashtë vendit, persona që kanë vdekur kohë më parë, apo persona që kanë lëvizur brenda vendit dhe janë të përfshirë në adresa të papërditësuara dhe të pasakta në listën e votuesve[2].

Diagnoza

Vetëm rreth gjysma e emrave të votuesve gjendet në qytete dhe fshatra ku ata janë të regjistruar për të votuar. Një auditim i vonë i auditimit të listës së votuesve që e zhvilloi D4D tregoi se vetëm 60% e votuesve në Kaçanik (komunë e vogël jugore) jetonin aty ku figuronin në listë. Pjesa tjetër prej 40% ishin ose jashtë vendit, kishin lëvizur, apo nuk mund të mirreshin parasysh[3]. Si një komunë e vogël dhe etnikisht homogjene, Kaçaniku është sigurisht shembulli më i mirë sa i përket saktësisë së listave të votuesve. Komunat më të mëdha dhe të përziera me siguri do të shfaqnin një trend të kundërt me më pak se 50% të listave të sakta.

Kur emigrantët e Kosovës votojnë jashtë shtetit përmes sistemit të postës, vota e tyre mund të refuzohet nëse dikush tashmë i ka shenjuar emrat e tyre në listën origjinale të votuesve në Kosovë. Këta qytetarë figurojnë në lista si votues të rregullt në adresën e tyre të vendbanimit në Kosovë. Derisa emigrantët kanë të drejtë të votojnë, madhësia e diasporës paraqet një sfidë për administratorët e zgjdhjeve që t'i inkuraajonë ata të votojnë dhe që të sigurojnë se vota e tyre nuk manipulohet.

Problemi me personat e vdekur është më serioz dhe një shkelje e qartë ligjore. Anëtarët e familjes nuk i raportojnë vdekjet në mënyrë rutinore, e edhe në raste kur i raportojnë, komunat shpesh nuk i raportojnë këta emra në mënyrë adekuate tek Ministria e Punëve të Brendshme. Disa emra hiqen nga lista e statusit civil, por nuk hiqen nga regjistri civil. Sfidat tjera në lidhje me listat e votuesve janë personat të cilat janë në regjistrin civil por nuk e kanë marrë letërnjoftimin e Kosovës si dhe personat të cilët nuk e raportojnë ndryshimin e adresës së tyre.

Individët të cilët kanë lëvizur përbrenda komunës së tyre mbeten në listën e votuesve me adresat e tyre paraprake dhe shpesh nuk votojnë sepse emrat e tyre gjenden në qendrat paraprake të votimit, shpesh disa kilometra larg. Votuesit e rinj (që i kanë mbushur 18 vjet) nuk përcaktohen sipas adresës por vendosen në një qendër votimi. Në

2 IFES, Vlerësimi i Ekstraktit të Regjistrit Civil në Kosovë, Janar 2011, http://elibraria.org/assets/2011-04-18t-IFES-Eval-of-K-Civil-Registry-Extract-English-Final-Report.pdf (qasja e fundit 19 mars 2012).Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Auditimi i Listës së Votuesve të Kaçanikut, Një mostër për Kosovën. http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_3_ENG_WEB.pdf (qasja e fundit 15 janar 2013). Raporti i vëzhgimit të ENEMO http://www.gndem.org/ENEMO-kosovo-assembly-elections-final-report-2010 (qasja e fundit 18 shkurt 2013), fq.10. EU EEM raporti i vëzhgimit http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010.pdf qasja e fundit 19 mars 2013), fq. 34.

3 Leon Malazogu, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Auditimi i Listës së Votuesve të Kaçanikut, Një mostër për Kosovën, Faqe 18. http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_3_ENG_WEB.pdf (qasja e fundit 15 janar 2013).

shumë qytete kjo është veçanarisht problematike dhe e zvogëlon daljen e tyre në votim. Votuesit shpesh e kuptojnë çvendosjen e tyre në Ditën e Votimit, kur u thuhet se e kanë gabuar qendrën e votimt.

Edhe pasaktësia më e vogël përgjatë këtij procesi nënkupton që Qendra për Regjistrim Civil nuk i heq emrat, dhe ata përfundimisht paraqiten në listën e votuesve. Shembulli i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunës në Ferizaj ka dëshmuar pamundësinë e KQZ-së për të intervenuar në listën e votuesve edhe kur kanë qenë të vetëdijshëm se në listë ka të dhëna që janë të pasakta. KQZ-ja ka ditur për rreth 1,300[4] votues që kishin vdekur në Ferizaj para se të zhvilloheshin zgjedhjet plotësuese komunale, por për shkak të të dhënave të pakompletuara këta emra nuk mund të hiqeshin (detyrë e Ministrisë së Punëve të Brendshme).

Frika mbetet që për secilin person i cili ka të drejtë vote dhe nuk e bën këtë (qofshin ata jashtë vendit, personat e vdekur, apo thjeshtë ata që zgjedhin të mos votojnë) mbetet mundësia që të tjerët të votojnë në emër të tyre. Niveli i pasaktësisë tregon se çdo dalje mbi 60% është teknikisht e pamundur. Shumica e zgjedhjeve me pak ose aspak tregues të mashtrimeve raporton dalje me 30-40%. Ka komuna ku dalja në mënyrë rutinore arrin deri rreth nëntëdhjetë përqind—tregues i padyshimtë i mashtrimeve masive. Ne kemi gjedur shembullin e një fshati në Kaçanik me dalje mbi 90% në vitin 2010 dhe me më pak se 30% në vitin 2012[5].

Çdo vit, lista e votuesve e Kosovës shtohet me katërdhjetë deri në pesëdhjetë mijë votues derisa rritja neto e popullsisë para 18 vjetësh ishte vetëm rreth njëzetë mijë. Lista e votuesve paraqet ekstrakt më të vonë në dispozicion të Regjistrit Qendror Civil" [6] e cila mirëmbahet dhe menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Derisa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për mirëmbajtjen e listës së votuesve[7], ai nuk ka asnjë ndikim në regjistrin civil.

Ilaçi

Ministria e Punëve të Brendshme është ligjërisht përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit civil në formën e tij elektronike, por ata duhet të punojnë më për së afërmi me komunat për t'i përditësuar të gjitha informata në kohë reale, duke përfshirë edhe vendbanimet e përhershme. Derisa KQZ-ja mund të zhvillonte një pastrim të nivelit të vogël, është më e dobishme nëse zhvillohet një auditim për regjistrin e përgjithshëm civil, meqë kjo automatikisht do ta përmirësonte listën e votuesve /regjistrin civil. Është inkurajues fakti që përmes ndihmës së projektit nga Komisioni Europian janë bashkuar bazat e të dhënave të statusit civil dhe të regjistrit civil. Nëse regjistri civil nuk mund të adresohet me kohë për zgjedhjet e ardhshme, KQZ-ja duhet ta nisë një proces paralel të regjistrimit aktiv për këto baza të të dhënave.

4 KQZ. 9 prill 2012. Takimi i rregullt I Komisionit Qendror Zgjedhor. [I vëzhguar nga përfaqësuesi i D4D].

5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Mësimet e marra për zgjedhjet nëë ardhmen, Analiza e zgjedhjeve plotësuese në Ferizaj dhe Kaçanik, http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_KacanikFerizaj.Eng_.pdf, p. 43. (qasja e fundit 19 mars 2013).

6 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 7.1 seksioni a.

7 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 7.1.

Votuesit nga diaspora duhet të vazhdojnë të ketë të drejtë vote, por autoritetet duhet ta përpilojnë një listë të qytetarëve të tyre që jetojnë jashtë vendit. Emrat e personave që jetojnë jashtë vendit për më shumë se gjysmë viti kalendarik automatikisht duhet të figurojnë në lista të ndara të votuesve në konzullata përkatëse jashtë vendit. Emrat e tyre duhet të shenjohen në atë mënyrë që t'u mundësojë softuerit t'i filtrojë votuesit sipas lokacionit, njejtë sikur i filtron votuesit sipas komunave. Kjo do ta përmirësonte daljen e tyre, dhe emrat e tyre nuk do të ishin në dispozicion në fshatrat e tyre në Kosovë për t'u shenjuar nga të tjerët. Çdo qytetar duhet të jetë ligjërisht i obliguar ta deklarojaë vendbanimin e vet të përhershëm, t'i raportojë ndryshimet e adresës me kohë, dhe të ballafaqohet me pasoja ligjore për dezinformim, që gjithashtu do t'i sjellte dobi alokimit më të mirë buxhetor për grantet komunale.

Kosovarët duhet të jenë të obliguar me ligj që t'i raportojnë anëtarët e vdekur të familjes. Certifikata e vdekjes duhet të lëshohet pa pagesë dhe duhet të parashihen gjoba për shkelje.

Problemi 2 – Vakumi ligjor dhe diskrecioni

Diagnoza

Zgjedhjet rregullohen pjesërisht me anë të Kushtetutës, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale, si dhe përmes legjislacionit sekondar nga KQZ-ja. Legjislacioni aktual për zgjedhjet është i papajtueshëm dhe dështon në rregullimin e një numri çështjesh të rëndësishme.

Meqenëse ligji nuk i rregullon zgjedhjet në detaje të mjaftueshme, ai është i papajtueshëm me praktikat më të mira ndërkombëtare[8]. Njëri prej dokumenteve me të cilin Kosova duhet të arrijë përputhshmëri në rrugën drejt integrimeve në BE, e siguron Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR):

Duhet të krijohet një kornizë e qartë dhe e detajuar legjislative për zhvillimin e zgjedhjeve përmes një ligji statutor, qoftë përmes një kodi gjithëpërfshirës apo përmes një sërë ligjesh që veprojnë së bashku në përputhshmëri dhe pa dykuptimësi apo lëshime[9].

Ligji është problematik për sa i përket asaj që dështon ta adresojë. Disa çështje adresohen me rregulloret e KQZ-së, vendosen nga KQZ-ja apo lihen në diskrecion të zyrtarëve individualë më poshtë në hierarki. Vakumi ligjor i lejon KQZ-së të rregullojë më shumë sesa që duhet dhe raportet e pavarura e kanë kritikuar kompetencën e tepërt të KQZ-së (shtjellohet në pikën e rradhës).Raporti i publikuar nga Eksperti i Zgjedhjeve i Bashkimit Europian Zyra në Kosovë thekson se:

8 Malazogu, Leon. Studim diskutimi mbi procesin zgjedhor. Tryezë tematike "Drejtësia, Liria dhe Siguria", fq.13.

9 ODIHR. tetor 2003. Zotimet ekzistuese për zgjedhjet demokratike shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Neni 2.5, fq. 13.

Është për të ardhur keq që [Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme] LZP-ja nuk e obligon KQZ-në në mënyrë specifike që të zhvillojë dhe publikojë udhëzime të detajuara, me shembuj të duhur, për implementimin e sistemit zgjedhor. Udhëzime të tilla do të kontribonin në masë të madhe në plotësimin e mangësisë në dispozitat ligjore dhe do t'i qartësonte dykuptimësitë ekzistuese[10].

Mundësia që vakumi ligjor të plotësohet përmes legjislacionit të tepruar nga KQZ-ja është problematike sidomos duke marrë parasysh përbërjen politike të këtij trupi. Çështjet të cilat janë shumë të rëndësishme për procesin zgjedhor janë plotësisht të lëna jashtë legjislacionit. Ekzistojnë shembuj siç janë financimi i partivë politike, shpenzimet e fushatave dhe deklarimi financiar, përfshirja e zyrtarëve publikë gjatë fushatave, qendra e numërimit dhe e rezultateve si dhe vëzhgimi i saj, periudha për sfidimin dhe konfirmimin e listës së votuesve, turmat në qendrat e votimit, roli i dhomave operative, nënshkrimet për partitë e reja, apo alokimi i roleve të komisionerëve në Ditën e Votimit.

Ilaçi
Për ta parandaluar KQZ-në me përbërje politike që të shndërrohet në trup udhëheqës legjislativ për qëllime zgjedhore, legjislacioni sekondar duhet të integrohet ose në një Ligj më të avansuar për Zgjedhjet, në Kodin e Zgjedhjeve ose përmes një sërë ligjesh të përputhshme zgjedhore. Kjo do të mundësonte që ligjet që nxirren tash e tutje të jenë në gjendje t'i plotësojnë më mirë praktikat më të mira europiane.

10 Eksperti Zgjedhor i Bashkimit Europian Zyra nëë. 25 janar 2011. Raporti final, fq. 21.

Problems 3 – The CEC

Problemet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë të shumëllojshme dhe përfshijnë (a) mbivotimin, (b) mungesën e pavarësisë së anëtarëve të KQZ-së, dhe (c) kompetencat e menaxhmentit të zgjedhjeve.

3.1 Mbivotimi

Diagnoza
Kushtetuta e Kosovës përcakton madhësinë dhe përbërjen partiake të KQZ-së[11]. KQZ-ja përbëhet nga një përfaqësues prej secilës nga 6 grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Katër anëtarët e tjerë janë përfaqësues të komuniteteve joshumicë në Kosovë.
Është problematike që të katër përfaqësues të komuniteteve gati ekskluzivisht anojnë kah koalicioni qeverisës. Ky konstelacion mundëson mbivotim të vazhdueshëm në KQZ. Është kërcënuar kredibiliteti i vetë institucionit të arbitrit. Vetë neutraliteti i cili do të duhej ta bënte referin zbatues të besueshëm të ligjit është kompromentuar seriozisht. Kjo përbërje lë shumë pak parti opozitare në KQZ dhe ata nuk janë në gjendje t'i adresojnë ankesat e tyre.

Ilaçi:
Ndryshimi i përbërjes për të siguruar përfaqësim të barabartë ndërmjet koalicionit qeverisës dhe opozitës në KQZ do ta parandalonte mbivotimin. Përfaqësimi i balancuar në KQZ, 50% pozitë dhe 50% opozitë do të kërkonte shqyrtimin e Nenit 139 (4) të Kushtetutës. Përfaqësimi i barabartë ndërmjet pozitës dhe opozitës nuk nënkupton domosdoshmërisht zvogëlimin e

11 Kushtetuta e Kosovës, Neni 139.

numrit të përfaqësuesve të komuniteteve në KQZ meqë parashihet me Kushtetutën e Kosovës. Së pari do të alokoheshin ulëset për subjektet politike që garojnë për ulëset e rezervuara. Ulëset tjera do të alokoheshin për ta arritur barazpeshën ndërmjet pozitës dhe opozitës. Rezultati do të ishte një KQZ e balansuar së cilës i beson opozita.

3.2 Anëtarët e varur

Diagnoza
KQZ-ja përbëhet nga të emëruarit partiakë të cilët duhet të shërbejnë në mënyrë profesionale dhe të pavarur pasi të caktohen. Megjithatë, partia e cila i ka emëruar e ka fuqinë t'i tërheqë ata në çdo kohë dhe të emërojë një person të ri që në mënyrë efektive i bën ata shërbyes të interesave partiakë gjatë gjithë mandatit të tyre[12].

Një varësi e tillë është kundër praktikave ndërkombëtare, që parashohin se "organet që caktojnë anëtarë në komisione zgjedhore nuk duhet të kenë liri t'i kthejë mbrapsht, sepse kjo hedh dyshime mbi pavarësinë e tyre."

Ilaçi
Anëtarët e KQZ-së duhet të gëzojnë pavarësi më të madhe, dhe kur të caktohen, i emëruari i një partie politike duhet të shërbejë deri në dy mandate pa të drejtë kthimi mbrapsht.

12 ODIHR. tetor 2003. Zotimet ekzistuese për zgjedhjet demokratike shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Neni 2.5, fq. 13.

3.3 Kompetencat e menaxhmentit të zgjedhjeve

Diagnoza
Trajnimi dhe kapaciteti i stafit të KQZ-së gjatë procesit zgjedhor është i dobët, duke përfshirë edhe komisionerë të qendrave të votimit në Ditën e Votimit. Ka shumë raporte që tregojnë se procedurat nuk përcillen dhe se komisionerët ankohen në procedura të paqarta (p.sh. përdorimi i ID kartelave, materiali që mungon, kompetencat e kryesuesit të vendvotimit apo të menaxherit të qendrës së votimit, postimi i rezultateve në derë, etj.).

Një sekretariat i dobët përfundon duke iu nënshtruar KQZ-së, dhe kjo shihet më së miri nga politizimi i drejtorit të Sekretariatit. Është praktikë standarde ndërkombëtare që institucionet zgjedhore të ndihmohen nga një sekretariat profesional[13]. Rekrutimi i Kryeshefit Ekzekutiv të KQZ-së nuk duhet t'i lihet tekeve të KQZ-së. Sa për krahasim, Kosova tashmë ligjërisht siguron praktikat e sekretarëve permanentë të veçuar në secilën Ministri, që nuk mund të shkarkohen nga ministri të cilit ata i raportojnë.

Ilaçi
Ligji zgjedhor në mënyrë specifike duhet të kërkojë që KQZ-ja t'i trajnojë komisionet zgjedhore dhe të themelojë një zinxhir të përgjegjësive për keqmenaxhim dhe administrim zgjedhor me të meta.

13 ODIHR. October 2003. Zotimet ekzistuese për zgjedhjet demokratike shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Neni 4.3, fq. 14.

Është thelbësore që të fuqizohet sekretariati i KQZ-së pushteti i të cilit duhet të avansohet dhe gradualisht të marrë kompetenca për t'u zhvilluar në një organ profesional me veçim të mjaftueshëm nga KQZ-ja politike. Sekretariati duhet të jetë i pavarur dhe të veprojë në mënyrë të pavarur prej KQZ-së. Në fund, Kryeshefi nuk duhet të zgjedhet nga anëtarët e KQZ-së por duhet të punësohet përmes një gare të hapur dhe të jetë pjesë e shërbimit civil.

Zgjedhjet e vitit 2007 u karakterizuan mes tjerash edhe me keqpërdorime dhe manipulime, shkatërrim të fletvotimeve si dhe me falsifikime të rezultateve të votimit. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i anuloi rezultatet e votimit në 40 Qendra të Votimit dhe rreth 34,000 vota u dërguan me postë[14]. U procesuan vetëm 12 aktakuza dhe nuk u inicua asnjë proces gjyqësor për asnjërin prej këtyre rasteve.

Përfundimi i zgjedhjeve të vitit 2007 ishte vetëm një preludë drejt manipulimit 'industrial' të zgjedhjeve në vitin 2009 dhe 2010. Raporti i EU EEM tregon se shkalla e manipulimin ka qenë aq e lartë saqë ka qenë problem të bashkërendohen rezultatet ndërmjet KKZ-së dhe KQZ-së.

Më 15 dhjetor, EU EEM mori informata nga përfaqësuesi i KQZ-së në Qendrën për Numërim dhe Rezultate (QNR) në Prishtinë se, fillimisht, dalja në Gllogovc/Glogovac e raportuar nga KKZ-ja ishte diku 107%, pastaj u përmirësua në 90.4% dhe në fund u raportua nga KQZ-ja të ishte 87%[15].

ENEMO tregoi dallimin në daljet ndërmjet zgjedhjeve në vitin 2010 dhe zgjedhjeve të përsëritura në këto komuna në 2011 krahasuar me daljet në vitet e kaluara. Të dhënat e daljes së votuesve për Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë (2001 – 2010) janë të paraqitura në tabelën në vijim[16]:

	Kosovo	Deçan/ Dečani	Gllogovc/ Glogovac	Skenderaj/ Srbica	Mitrovicë/ Mitrovica
2001 KA Election	64.3%	66.3%	73.1%	64.3%	56.0%
2004 KA Election	49.5%	59.5%	65.8%	57.0%	45.9%
2007 KA Election	40.1%	45.8%	49.9%	52.8%	28.9%
*12/12/2010 KA Election *preliminary results cancelled by CEC*	*47.8%**	*48.4%**	*86.9%**	*93.7%**	*57.0%**
2010 KA Election (final results from 30/1/11 after repeat elections)	45.3%	34.6%	55.9%	59.8%	27.0%

Përderisa ka vullnet politik për manipulime dhe përderisa gjykatat ndikohen nga politika, është e vështirë t'i jepet fund mashtrimeve. Por një numër masash mund të zvogëlonte shkallën e manipulimit. Seksioni në vijim ngrit një sërë çështjesh kyçe në lidhje me ditën e zgjedhjeve dhe rekomandon veprime specifike për të parandaluar manipulime të shkallës së lartë në të ardhmen.

Problemi 4 – Drejtorët e shkollave dhe komisionerët e vendvotimeve

4.1 Drejtorët e shkollave si menaxherë të qendrave të votimit

Dihet mirë se gati të gjithë drejtorët e shkollave zgjedhen nga prerogativat politike dhe se kjo pozitë është njëra prej dhuratave kryesore të partive politike fituese për mbështetësit e saj aktivë. Përkundër afërsive politike që mund apo mund të mos e dëmtojnë rolin e tyre si drejtorë, në ditën e zgjedhjeve ata e marrin një rol që mund t'i sjellë dobi garës zgjedhore. Drejtorët e shkol-

14 Ibid

15 Raporti EU EEM, 13http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010.pdf, (Qasja e fundit 18 shkurt)

16 ENEMO, Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare në 2010, Raporti final. Shiko tek http://www.gndem.org/sites/default/files/Final%20Report%20ENEMO%20EOM%202010.pdf (Qasja e fundit 18 shkurt 2013).

lave zakonisht shërbejnë si menaxherë të qendrave të votimit dhe afërsia e tyre partiake ua vështirëson kryerjen e drejtë të detyrës së tyre në ditën e zgjedhjeve.

Diagnoza
Në praktikë ata kanë aftësi të ndikojnë në rregullsinë e procesit zgjedhor. Menaxherët/drejtorët e shkollave shpesh i tejkalojnë kompetencat e tyre logjistike dhe përfshihen në procesin zgjedhor në mënyrë aktive ose përmes neglizhencës. Ka raste të raportuara në të kaluarën kur një menaxher i qendrës së votimit/drejtor shkolle ushtroi presion tek komisionerët për t'i lejuar personat të votojnë përkundër faktit që u refuzuan nga Komisioni i Vendvotimit (KVV).

Roli kryesor i menaxherëve të qendrave të votimit është që të menaxhohen turmat dhe të sigurohet një proces i rregullt në korridoret e shkollave. Vëshgimi i D4D ka treguar se në shumë raste drejtorët e shkollave nuk e ushtrojnë detyrën e tyre primare të sigurimit të korridoreve pa turma në qendra të votimit. Problemet e shkaktuara nga turmat nëpër korridore diskutohen ndaras në seksionin e rradhës.
Ilaçi
Roli i drejtorëve të shkollave si menaxherë të qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve duhet të jetë vetëm i natyrës teknike, ta ndezë gjeneratorin, t'i hapë klasat për votim dhe kështu me radhë.

Drejtorët e shkollave nuk duhet të kenë të drejtë të hyjnë në vendvotime përveç në rastet kur ftohen nga KVV e edhe atëherë vetëm për qëllime teknike. KQZ-ja duhet të përgatisë një përshkrim rë detajuar të punës për menaxherët e qendrave të votimit.

4.2 Komisionerët e vendvotimeve

Komisionerët e vendvotimeve janë identifikuar si manipuluesit kryesorë të zgjedhjeve në vitin 2007, 2009 dhe 2010. Kjo u dokumentua më së miri nga misionet e ndryshme vëshguese ndërkombëtare dhe vendore dhe në fund u fuqizua me vendimet gjyqësore kundër komisionerëve të vendvotimeve. Kjo mund të duket sekondare dhe teknike por ky mund të jetë çelësi për parandalimin e shkeljeve masive në të ardhmen.

Diagnoza
Komisionerët e vendvotimeve si përfaqësues politikë e kanë keqpërdorur pozitën e tyre në vendvotime duke manipuluar me vullnetin e votuesve. Derisa votimi preferencial kishte për qëllim t'u ofronte votuesve mundësinë për ta zgjedhur kandidatin e tyre të preferuar, komisionerët e keqpërdorën këtë.

Në shumë raste votuesit votuan vetëm për një kandidat ndërsa katër kandidatët tjerë u zgjodhën nga komisionerët, një manipulim i qartë zgjedhor. Shumë raste u proceduan tutje në prokurori dhe pak vendime u morën nga gjykatat. Solidariteti lokal është shumë i fuqishëm dhe lojaliteti ndaj partisë dhe ndaj kandidatëve individualë në fund është vendimtar.

Ilaçi
Partitë politike duhet të marrin përgjegjësi ligjore për sjelljet e komisionerëve të tyre në vendvotime. Ndryshimi në ligjin për zgjedhje duhet të parashikojë që në rastet kur një komisioner i një vendvotimi dënohet për manipulim të zgjedhjeve, edhe entiteti politik i atij komisioneri duhet të gjobitet. KQZ-ja gjithashtu duhet të bartë përgjegjësi për zinxhirin komandues dhe t'i adresojë mangësitë në mënyrë të duhur te i gjithë stafi i saj. Më e rëndësishmja, në ditën e

zgjedhjeve komisionerët duhet të caktohen në zonat tjera nga ato të cilave u përkasin për të mënjanuar faktorin e solidaritetit lokal.

Problemi 5 – Turmat

Çështja e drejtorëve të shkollave është e lidhur ngushtë me atë të turmave përpara shkollave dhe brenda korridorëve të shkollave. Vendvotimet, qendrat e votimit si dhe perimetri i menjëhershëm përreth shkollave i mbushur plotë me njerëz krijojnë një atmosferë të rrëmujës dhe shkaktojnë frikë nga ndikimi i mundshëm dhe kanosja e votuesve.

Diagnoza
Vëzhgimi ka treguar se turmat përreth qendrave të votimit ose brenda tyre krijohen qëllimisht për t'i shërbyer një qëllimi specifik. Turmat krijohen edhe kur nuk ka rreshta për të votuar dhe kryesisht krijohen nga numri i madh i militantëve politikë dhe vëzhguesit e akreditуar partiakë.

Derisa numri i vëzhguesve partiakë përbrenda vendvotimit është i kufizuar në dy vëzhgues, numri total i vëzhgiesve të akreditуar partiakë për një parti politike është i pakufizuar, që u mundëson t'i vërshojnë korridoret dhe oborret e shkollave për të ushtruar ndikim të padrejtë tek votuesit. Dersia problemi me personat pa distinktiv i takon së kaluarës, problemi i njejtë shfaqet përsëri, por tani shkaktohet nga vëzhguesit pa distinktiv.

Ilaçi
Problemi është i dyfishtë dhe mund të adresohet duke u marrë me këto dy çështje (a) numri i përgjithshëm i vëshguesve të akreditуar, dhe (b) roli i drejtorëve të shkollave (e dyta u diskutua pjesërisht në seksionin e kaluar).

Numri i vëzhguesve për parti politike dhe i subjekteve tjera vëzhguesve për vendvotim duhet të kufizohet në

maksimum një vëzhgues për entitet. Numri total i vëzhguesve të akreditуar gjithashtu duhet të kufizohet duke mos tejkaluar 10% të numrit total të vendvotimeve.

KQZ-ja duhet të kërkojë llogaridhënie nga drejtorët e shkollave që të mos ketë vëzhgues nëpër korridore apo oborre të shkollave në një perimetër prej 100 metrash. Një rregullore e miratuar nga KQZ-ja duhet të përshkruajë në detaje hapat të cilat menaxherët e vendvotimeve duhet t'i ndërmerrnin për të parandaluar turma dhe t'i obligojë ata që të sigurojnë një ambient të përshtatshëm.

Problemi 6 – Kanosja e votuesit

Diagnoza
Kanosja e votuesit vazhdon në forma të ndryshme. Një mekanizëm i elaboruar i kanosjes është thirrja e votuesve të cilët nuk kanë votuar gjatë ditës së zgjedhjeve, duke i pyetur ata se pse nuk kanë votuar.

Vazhguesit partiakë e kanë një detyrë rutinore të shikojnë se kush nuk ka votuar. Ata e përcjellin këtë informacion tek vëzhguesit në korridor (kjo është arsyeja pse është shumë me rëndësi që turmat në korridor të shpërndahen). Votuesit kontaktohen dhe partia i pyet se pse nuk kanë votuar akoma. Vëzhguesit e korridoreve shëbejnë si 'qendra të thirrjeve' dhe krijojnë lidhje me vozitësit të cilët i marrin votuesit nëpër shtëpi dhe i sjellin nëpër qendra të votimit. Një 'kurreshtje' e tillë mund të perceptohet si kanosje sepse votuesit brengosen në lidhje me aftësinë e partisë për të ditur nëse ata kanë votuar apo nuk kanë votuar.

Shqetësimi për këtë informacion 'të privilegjuar' mund t'i brengosë votuesit sepse nëse partia është në dijeni nëse ata kanë votuar ata gjithashtu mund të dijnë se për kë kanë votuar. Kjo ndjenjë është më e theksuar nëpër fshatra ku investimet kontrollohen në mënyrë direkte nga partia në pushtet në atë komunë. Kjo teknikë ka më shumë mundësi të ketë efekt në fshatra të vogla rurale sesa në qytetet kryesore. Kjo është arsyeja e vetme se pse ekziston hutia kur zgjedhjet nëpër fshatra e favorizojnë fituesin shumë më shumë sesa në qytete. Për shembull, kryetari i komunës së Kaçanikut fitoi më shumë se dy të tretat e votave në fshat dhe më pak se një të tretën në qytet[17]. Duke e marrë parasysh sistemin e elaboruar të patronazhit si dhe mbizotërimin e sektorit publik si punëdhënës kryesor në Kosovë, votuesit brengosen për humbje të vendeve të tyre të punës dhe të familjarëve të tyre.

Ilaçi
Fakti nëse ndonjë person ka votuar apo jo duhet të jetë çështje private dhe kjo duhet të rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet dhe/ose me Ligjin për Provatësinë.

Komisionerët nuk duhet ta kenë të drejtën ta kontrollojnë librin e votuesve për të parë se kush ka votuar e kush jo. Duhet të parashihen gjoba për personat të cilët e shkelin këtë rregull dhe abuzojnë me informata konfidenciale. Të gjithë komisionerëve (ndoshta përveç kryesuesit) duhet t'u ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë.

17 Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi. Mësimet e marra për zgjedhjet nëë ardhmen, Analiza e zgjedhjeve plotësuese në Ferizaj dhe Kaçanik, http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_KacanikFerizaj.Eng_.pdf, faqe 53. (Qasja e fundit 19 mars 2013).

Ndërsa korridorët kontrollohen nga menaxherët e qendrave të votimit, policia duhet të jetë më e vëmendshme dhe të patrollojë në perimetrin e jashtëm si dhe të kontrolojë nëse ka blerje të votave dhe forma të tjera të organizimeve të jashtëligjshme.

Problemi 7 – Fshehtësia e votës

7.1 Fotografimi

Fotografimi i fletëvotimit nga ana e votuesit ka vetëm një spjegim, votuesi e dëshmon lojalitetin ndaj partisë kur ekziston shumë pak besim ndërmjet tyre.

Diagnoza

Një tregues se po bëhet fotografimi është gjatësia e kohës për të votuar. Shumë votues marrin shumë kohë për të votuar, duke ngritur dyshime se ata janë të zënë me diçka më shumë sesa vetë votimi. Është e kuptueshme se votuesve në moshë dhe gjysmë-analfabetë u duhet më shumë kohë për të votuar. Por edhe në zgjedhjet plotësuese për kryetar të komunës (me 6-7 emra), duke përfshirë edhe raundin e dytë (me vetëm dy emra), gati një e treta e votuesve shpenzuan më shumë se një minutë për të votuar[18].

Fotografimi i fletëvotimit ka të bëjë me korrupsionin ose blerjen e votave. Votuesi shantazhohet dhe duhet t'ia dëshmojë shenjën partisë për të marrë beneficione të premtuara, ose për ta shmangur ndonjë dënim. Fotografitë mund t'u tregohen zyrtarëve partiakë, dhe disa përfitojnë, zakonisht para, në këmbim të votës së tyre.[19]

Ilaçi

Fotografimi i fletëvotimit është i ndaluar me ligj por është shumë vështirë të zbatohet. Zgjidhja e vetmë është që t'u ndërrohet pozita kabinave të votimit dhe të kthehen në drejtimin e kundërt. Vazhguesit do ta shihnin shpinën e secilit votues dhe gjithashtu do të ishin më shumë në gjendje t'i dallonin lëvizjet e dyshimta siç është nxjerrja e celularit. Kjo është praktikë standarde dhe fshehtësia e votës ende ruhet. Policia duhet të patrullojë në zonat në afërsi të qendrave të votimit, duke identifikuar zyrtarë partiakë të cilët japin udhëzime dhe i paguajnë votuesit pasi t'u kenë treguar fotografitë.

7.2 Treni bullgar

Ka raste të raportuara kur letra të bardha apo letra të tjera janë gjetur brenda kutive të votimit. Ky është një tregues se votuesi e ka marrë fletëvotimin origjinal me veti dhe ka vendosur diçka tjetër në kurtinë e votimit.

18 Leon Malazogu dhe Selatin Kllokoqi. Mësimet e marra për zgjedhjet nëë ardhmen, Analiza e zgjedhjeve plotësuese në Ferizaj dhe Kaçanik, http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_KacanikFerizaj.Eng_.pdf, faqe 30. (Qasja e fundit 19 mars 2013).

19 Besa Shahini. 3 maj 2012. Selam prej Ferizajt, Gazeta Jeta në Kosovë. http://gazetajnk.com/?cid=1,1015,2057 (Qasja e fundit 25 janar 2013).

Teknologjia qëndron në atë se fletëvotimi i paplotësuar bie në duart e militantit partiak jashtë qendrës së votimit i cili e plotëson fletëvotimin dhe ia jep atë votuesit të radhës. Votuesi i radhës e nxjerrë fletëvotimin tashmë të plotësuar dhe e fut në kutinë e votimit ndërsa ia sjell fletëvotimin e paplotësuar militantit partiak që rri jashtë.

Kjo formë e manipulimit e cila mund të zgjasë gjatë gjithë ditës nuk është shpikje e Kosovës dhe tanimë gëzon emrin e "trenit bullgar". Kjo është një formë më e elaboruar me efekt të njejtë sikurse fotografimi dhe mundëson blerje të votave.

Kjo formë e manipulimit është madje më e lehtë kur lejohet votimi me kusht sepse bëhet edhe më e vështirë të kapen fletëvotimet 'e rrejshme'. Vendosja e fletëvotimit të rrejshëm apo e një cope të gazetës është lehtë kur dikush voton me kusht dhe kjo mund të zbulohet vetëm kur e gjitha të përfundojë, në mos fare. Fletëvotimet me kusht mundësuan një modifikim shpikës të 'trenit', duke vendosur adresa, dhe këto vota përfunduan duke u refuzuar. Këto zakonisht nuk hapen fare, që zgjon dyshime në lidhje me zgjedhjen e politikave nga ana e autoriteteve të menaxhimit të zgjedhjeve.

Në vitin 2012, fletëvotimet e refuzuara me kusht gjithashtu u hapën pas zgjedhjeve plotësuese për kryetar të komunës në Ferizaj dhe Kaçanik dhe frikat më të mëdha u materializuan – u gjet se tetë fletëvotime të raundit të parë ishin hedhur në raundin e dytë[20]!

20 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 1 qershor 2012. Takimi i rregullt i KQZ-sw (Takimi Nr. 39. [Vwzhguar nga pwrfaqwsuesi i D4D].

Ilaçi

Kthimi i kabinave të votimit në drejtim të kundërt nuk është vetëm zgjidhje ndaj fotografimit (siç u diskutua në seksionin e kaluar) por edhe ndaj parandalimit të votuesve për të nxjerrë fletëvotime të rrejshme nga xhepat e tyre. Vota me kusht gjithashtu duhet të hiqet, por kjo varet në masë të madhe nga saktësia e listave të votuesve. Nëse nuk i jepet fund fletëvotimeve me kusht, duhet të futet pjesa detyruese e procedurës për t'i hapur të gjitha fletëvotimet me kusht, duke përfshirë edhe të refuzuarat. Nëse gjenden fletëvotime të rrejshme, menjëherë duhet t'i përcillen prokurorisë.

Problemi 8 – Fletëvotimi me kusht dhe me postë

Diagnoza

Fletëvotimet me kusht përdoren në mënyrë rutinore për të votuar për të tjerët. Gati gjysma e fletëvotimeve me kusht refuzohet si e pavlefshme qoftë për shkak të adresave të gabuara, apo për shkak se emrat e njejtë tashmë ishin shenjuar në fletat origjinale të nënshkri-

meve[21]. Një ilustrim interesant është rasti në Ferizaj në vitin 2012 ku paradoksalisht kishte më shumë fletëvotime me kusht për raundin e dytë sesa për raundin e parë[22].

Akoma më keq, votuesve legjitimë, të cilët nuk janë në gjendje të votojnë në lokacionet e tyre të preferuara dhe zgjedhin të votojnë përmes postës, ndodh që votat t'u shpallen të pavlefshme. Kur fletëvotimi arrin nga jashtë përmes postës, emri në pjesën e jashtme të zarfit krahasohet me nënshkrimin origjinal. Nëse dikush ia ka dalë të votojë dhe të nënshkruhet me emrin e tij/të saj, fletëvotimi i cili ka arritur përmes postës do të eliminohet madje edhe para se të hapet brendësia e zarfit.

Ilaçi
Është lajm i mirë që ekziston një konsenzus i gjerë që të hiqen fletëvotimet me kusht. Duhet të theksohet se nëse nuk adresohet lista e votuesve, heqja e fletëvotimeve me kusht mund të shkelë të drejtën e votës që është e drejtë themelore e njeriut. Vendosja e diasporës në një listë të veçantë të votuesve gjithashtu eliminon mjaft hapësirë për një mashtrim të tillë.

21 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 5 qershor 2012. Takimi i rregullt i KQZ-sw (Takimi Nr. 40. [Vwzhguar nga pwrfaqwsuesi i D4D].
22 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Mësimet e marra për zgjedhjet nëë ardhmen, Analiza e zgjedhjeve plotësuese në Ferizaj dhe Kaçanik, http://d4d-ks.org/assets/D4D_Elections_KacanikFerizaj.Eng_.pdf, faqe 33. (Qasja e fundit 19 mars 2013)

Problemi 9 – Votimi për tjetrin

9.1 Lokacioni i vëzhguesve

Diagnoza
Rregullimi standard i një qendre të votimit ua pamundëson vëzhguesve pozitën nga e cila ata mund t'i shohin nga afër dokumentet e identifikimit të votuesve. Më shumë në rolin e spektatorit, vëzhguesit vështirë se mund të vëzhgojnë nëse votuesit nënshkruhen me emrat e tyre.

Pozita e vëzhguesve nuk është e rregulluar me ligj, edhe pse ligji parasheh që ata kanë të drejtë ta vëzhgojnë procesin nga afër, gjë që mund të interpretohet ndryshe. Zgjedhjet plotësuese për kryetar të komunës në Ferizaj dhe Kaçanik i ndryshuan lokacionet e vëzhguesve, por kjo ende duhet të rregullohet me ligj.

Ilaçi
Vëzhguesve duhet t'u lejohet të ulen prapa komisionerit për ID dhe komisionerëve të tjerë në mënyrë që ta vëzhgojnë procesin në mënyrë aktive. Pas një zhurme të madhe nga ana e shoqërisë civile, vëzhguesve iu lejua të uleshin prapa komisionerëve në zgjedhjet plotësuese për kryetar të komunës në Ferizaj dhe Kaçanik. Duhet të futet formulimi më i mirë në ligj i cili parasheh 'vështrim nga afërisa që u mundëson vëzhguesve t'i shohin dhe inspektojnë të gjitha fazat e votimit përveç atyre të cilat nuk e shkelin privatësinë e votës'.

9.2 Komisioneri për ID

Diagnoza
Pa e minimizuar rolin dhe rëndësinë e secilit komisioner në ditën e zgjedhjeve, komisioneri për ID është identifikuar si zyrtari kyç i cili gati vetë mund të ndikojë në mënyrë direkte në rezultatin e zgjedhjeve. Komisioneri për ID ka një rol thelbësor që mund ta lehtësojë votimin për tjetrin në ditën e votimit. Kontrolluesit e dokumenteve të identifikimit lejojnë votim me identifikim joadekuar apo lejojnë nënshkrim në emër të tjetërkujt.

Ligji ishte i heshtur sa i përket kësaj shpërndarjeje dhe ua la kryesuesve të vendvotimeve t'u alokojnë këto pozita partive të ndryshme të cilat i emërojnë komisionerët. Kjo ishte problematike dhe shpeshherë një parti e vetme e fitonte këtë pozitë në shumicën e vendvotimeve (ishte më e lehte para se kjo teknikë të zbulohej nga ana e shoqërisë civile)[23].

Roli i tepruar i komisionerit për ID është i lidhur ngushtë me listën e votuesve dhe me diasporën. Përveç lejimit të votimit të shumëfishtë, kjo e shkel të drejtën e të tjerëve për të votuar. Nëse komisionerët vijnë nga komuna ku ata shërbejnë në ditën e votimit, ata poashtu e dijnë se cili nga emrat jeton jashtë shtetit dhe cili ka vdekur. Kjo mundëson një shkallë më të lartë të votimit për tjetrin në emër të atyre që jetojnë jashtë. Në këtë mënyrë, kjo mund t'i mundësojë ata t'i drejtojnë votuesit me të cilët bëjnë hesape tek emrat që ka shumë pak mundësi të dalin në votim.

23 KTV. 19 prill 2012. Programi Interaktiv mund të shikohet këtu: http://www.kohavision.net/video/interaktiv/3936/

Ilaçi
Pas avokimit nga ana e shoqërisë civile, ky rol u shpërnda proporcionalisht tek të gjitha partitë politike, por vetëm për Ferizaj dhe Kaçanik. Ngjashëm si me lokacionin e vëzhguesve, shpërndarja e komisionerëve duhet të rregullohet me ligj dhe të mos i lihet tekeve të KQZ-së.

Duke marrë parasysh modelin e vendeve të tjera të cilat kanë identitete lokale dhe lojalitete të fuqishme, Kosova duhet t'i shpërndajë komisionerët në zonat e tjera nga ato prej të cilave vijnë në ditën e zgjedhjes. Ata mund të votojnë një ditë përpara, ngjashëm sikurse ndodh edhe votimi i personave me nevoja te veçanta nëpër spitale apo me pacientët që nuk dalin dot nga shtëpia dhe shtrati.

Problemi 10 – Votimi në grup

Votimi familjar dhe votimi me asistencë është bërë më i nevojshëm për shkak të një procesi të komplikuar të votimit i cili duhet të thjeshtësohet. Përveç mjeteve teknike për t'u ballafaquar me këtë fenomen, rekomandohet fuqishëm një sistem me vetëm një shenjë për fletëvotim.

10.1 Votimi familjar

Diagnoza

Votimi familjar është shkelje e të drejtave të njeriut dhe e privatësisë së anëtarëve të familjes. Në shumicën e rasteve votimi familjar shkel privatësinë e grave dhe të të moshuarve në zonat rurale. Argumenti se shumica e anëtarëve të familjes votojnë njejtë dhe se shumica janë analfabetë nuk tingëllon shumë bindshëm dhe duhet të kundërshtohet.

Votimi familjar është i ndaluar me ligj por vëzhguesit në mënyrë rutinore raportojnë për votime familjare në gati çdo vendvotim. Fenomeni është shumë i përhapur dhe perceptimi se kjo është një shkelje është shumë i dobët. Si rezultat i kësaj, komisionerët nuk ndërmarrin ndonjë masë kundër kësaj dhe nuk udhëzohen nga KQZ-ja që ta parandalojnë apo ta pengojnë fuqishëm këtë fenomen.

Ilaçi
Të organizohet një fushatë kundër votimit familjar dhe të udhëzohen komisionerët se si të mirren me rastet, të udhëzohen votuesit sa i përket të drejtës së tyre. Komisionerët duhet të udhëzohen që të insistojnë më fuqishëm për t'i zvogëluar rastet e votimit familjar. Duhet të përcaktohen qëllimet për ta sjellur këtë trend në nivelin zero brenda disa vitesh.

10.2 Votimi me asistencë

Diagnoza
Derisa votimi familjar është shkelje e qartë ligjore, votimi me asistencë lejohet por prapëseprapë është shqetësues. Në shumë raste personi i njejtë u ofron ndihmë disa votuesve gjë që është e ndaluar me ligj.

Ligji parasheh që secili votues që kërkon asistencë duhet të asistohet, por një person mund t'i asistojë vetëm një personi gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve. Vëzhguesit e shoqërisë civile kanë vërejtur se individët që bredhin korridoreve u ofrojnë 'asistencë' të moshuarve.

Ilaçi
Personat që e asistojnë më shumë se një person duhet të ballafaqohen me drejtësinë dhe duhet të trajtohen si manipulues të zgjedhjeve. Këta persona, duke përfshirë ata në korridor që u ofrojnë asistencë votuesve në moshë, duhet të ndiqen për kanosje dhe manipulim. Kjo përsëri e teston vendosmërinë e menaxherit të qendrës së votimit i cili duhet të jetë më i vendosur për t'i përmbushur detyrat që i janë caktuar. Mbetet problematik fakti që opinioni publik nuk i konsideron aktet e tilla si shkelje të qarta dhe ekziston një dozë butësie dhe mungese vetëdijësimi sa i përket shkallës në të cilën kjo e shtrembëron vullnetin e individit.

Problemi 11 – Vota preferenciale

Diagnoza
Votimi preferencial ia ka shtruar rrugën manipulimit masiv të rezultatit të zgjedhjeve nga vetë individët të cilët e kanë për detyrë ta mbrojnë, nga komisionerët e vendvotimeve. Votimi preferencial nënkuptonte që votuesit duhej ta shenjonin partinë dhe gjithashtu deri në pesë kandidatë (të cilët përputhen me emrat e shkruar në një vend tjetër) që i përkisnin preferencës së parë. Zgjedhjet në 2009 dhe 2010 kanë treguar se komisionerët kanë abuzuar në mënyrë masive me votimin preferencial.

Disa votues i shenjuan numrat pa e shenjuar partinë që komisionerëve u ofronte një stimulim që ta plotësonin partinë e preferuar më vonë. Votuesit e tjerë e shenjuan partinë dhe emrat i lanë të paplotësuar, që u ofronte militantëve partiakë dhe përkrahësve të kandidatëve të caktuar një stimulim për të mos e lëshuar këtë shansë të madhe.

Fenomeni më i përhapur ishin votuesit të cilët i shenjuan 2-3 kandidatë të preferuar. Komisionerët i shtuan emrat shtesë për t'u siguruar të mos e humbnin shansin ta përdorin maksimumin prej pesë mundësive. Pas kësaj u mbushën fletëvotimet e zbrazëta, ndërsa fletëvotimet e rregullta të partive pa komisionerë u shpallën të pavlefshme.

Në disa zona procesi mori përmasa industriale duke mos lënë gati asnjë fletëvotim të vlefshëm për partitë më të vogla, asnjë fletëvotim të zbrazët, dhe dalja arriti 100%.

Asryeja kryesore pse kemi mjaft njohuri sot sa i përket mashtrimeve është pakënaqësia e brendshme partiake. Shumë zyrtarë partiakë akuzuan se 'shenjat shtesë' të atij lloji nuk ishin thjesht dëshirat individuale por ishin të orkestruara. Gjithashtu kemi njohuri përmes vazhguesve dhe një aktivist i D4D e raportoi një video incizim në mbrëmjen e zgjedhjeve në vitin 2010.

Ilaçi

Mjeti më evident kundër këtij fenomeni është të hiqen votat preferenciale, të hiqet opsioni për të votuar për disa kandidatë. Andaj, për ta ruajtur parimin e listave të hapura dhe njëkohësisht për ta parandaluar mundësinë e vjedhjes së votave, rekomandimi është që sistemi i ri zgjedhor të miratojë modelin "një shenjë" ku listat do të jenë të hapura, por votuesit do të kenë mundësi të votojnë vetëm për një kandidat nga partia e tyre e preferuar. Asnjë katror nuk duhet të vendoset pranë emërtimit të partisë. Kështu, votuesi nuk do të jetë në gjendje të votojë vetëm për partinë meqë kjo do të mund t'i linte emrat individualë të paplotësuar dhe do të shërbente si një stimulim për komisionerët që t'i plotësojnë emrat sipas zgjedhjes së tyre.

Problemi kryesor është se heqja e votës preferenciale pa futjen e zonave zgjedhore do t'i linte 110 opsione për emra për secilën parti. Një fletëvotim i tillë i papërshtatshëm do ta shtynte shumicën e votuesve ta shenjojnë liderin pa hamendje dhe ta fuqizojnë hierarkinë brenda partive të tyre.
Opsioni tjetër që ndonjëherë sugjerohet është përdorimi i skanerëve dhe centralizimi i numërimit por kjo është plot me rreziqe të tjera. Është përparësi nëse nuk hapen kutitë në qendrën e votimit por vetëm në një lokacion të destinuar qendror por transporti e shton frikën e zëvendësimit të tyre.

Disa i konsiderojnë si sakrificë listat e hapura dhe sugjerojnë mbylljen e tyre. Kjo duhet të rezistohet sepse ky është me siguri suksesi më i madh që e ka arritur shoqëria civile që detyron të paktën një demokraci minimale brenda partive. D4D dhe Forumi i Shoqërisë Civile kanë rekomanduar një model të elaboruar se si të përputhen të gjitha parimet në një mes të artë[24].

Problemi 12 – Gjobat e ulëta & Gjykatat jofunksionale

Diagnoza
KQZ-ja dhe PZAP-i ia përcollën prokurorisë një numër të vogël shkeljesh. Edhe më pak shkelje u hetuan dhe u gjykuan. Një numër shumë i vogël në fund u gjykua dhe në të shumtën e rasteve me gjoba simbolike. Numri i vogël i dënimeve me burg është qesharak.

Duke shqyruar pak raste dhe duke shqiptuar gjoba shumë të ulëta, gjykatat nuk kanë ndihmuar në ndaljen e mashtrimeve zgjedhore. Ka pasur raste kur gjobat kanë qenë vetëm pesëqind euro. Këto gjoba nganjëherë ishin nën nivelin e ndëshkimit që parashihet me ligj. Në përgjithësi, gjobat e ulëta që rralëherë shqiptohen i stimulojnë mashtrimet në vend se t'i parandalojnë.

Ilaçi
Elitat politike duhet të ushtrojnë presion ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve për të ndikuar në rezultatin e drejtësisë zgjedhore. Gjykatat në Kosovë janë të stërmbushura me raste, por mashtrimet zgjedhore duhet të jenë prioritet.

Kosovarët duhet t'u bëjnë presion gjykatave që të jenë më këmbëngulëse në ndjekjen e krimeve zgjedhore të

24 Forumi Reforma Rekomandimet për Sistemin Zgjedhor, http://d4d-ks.org/aktivitetet/rekomandimet-e-forumit-reforma-per-sistemin-zgjedhor/?lang=en. (qasja e fundit 19 mars 2013).

kësaj natyre dhe të natyrave tjera, por shpresat nuk janë të mëdha. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të ballafaqohen me pasoja profesionale dhe gjyqësore nëse shqiptojnë gjoba të ulëta që nuk parashihen madje as nga ligji i aplikueshëm. Më shumë detaje në ligj në lidhje me mjetet juridike do ta ngushtonin hapësirën për maturi të gjyqtarëve.

Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur
Projekat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo
Project of the Kosovo Foundation of Open Society